

**LIGJ**  
**PËR MËSIMDHËNËS DHE BASHKËPUNËTORË PROFESIONALË NË SHKOLLA**  
**FILLORE DHE TË MESME**

**I. DISPOZITA E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Me këtë ligj rregullohen kushtet për kryerje të profesionit mësimdhënës dhe bashkëpunëtor profesional në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, themelimi i marrëdhënies së punës, kategoritë e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, detyrat e punës, përsosja e vazhdueshme profesionale (zhvillimi profesional), avancimi në tituj (zhvillimi në karrierë) dhe heqja e titullit.

**II. STAZHI I PRAKTIKANTIT**

**Neni 2**

(1) Mësimdhënësi dhe bashkëpunëtor profesional që për herë të parë punësohet në shkollë fillore përkatësisht të mesme është mësimdhënës – praktikant përkatësisht bashkëpunëtor profesional – praktikant.

(2) Stazhi i praktikantit zgjat një vit.

(3) Gjatë stazhit të praktikantit, praktikantit i takon pagë në lartësi prej 90% të pagës së mësimdhënësit përkatësisht bashkëpunëtorit profesional.

(4) Gjatë stazhit të praktikantit, personat nga paragrafi (1) i këtij neni aftësohen për punë të pavarur edukativo-arsimore, përkatësisht profesionale nëpërmjet përvetësimit të kompetencave themelore profesionale.

(5) Praktikanti gjatë stazhit të praktikantit bashkëpunon me mësimdhënësit përkatësisht bashkëpunëtorët profesionalë dhe përgatitet për provim profesional.

(6) Gjatë stazhit të praktikantit, praktikantin e udhëheq/udhëzon mentori.

(7) Mentori i praktikantit duhet të ketë titull mësimdhënës-mentor ose mësimdhënës-këshilltar, përkatësisht bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar.

(8) Me përjashtim nga paragrafi (7) i këtij neni, nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të mentorëve dhe këshilltarëve në komunë, përkatësisht në qytetin e Shkupit, në territorin e të cilit është shkolla, mentori zgjidhet nga radhët e mësimdhënësve përkatësisht bashkëpunëtorëve profesionalë të shquar, të cilët i posedojnë kompetencat dhe standardet themelore profesionale për mësimdhënës-mentor, përkatësisht bashkëpunëtor profesional-mentor, kanë së paku shtatë vite përvojë pune si mësimdhënës, përkatësisht bashkëpunëtor profesional në shkollë.

(9) Mentori i bashkëpunëtorit profesional mund të jetë bashkëpunëtor profesional i profilit të njëjtë arsimor.

(10) Nëse nga paragrafi (9) i këtij neni në shkollën fillore përkatësisht të mesme nuk ka bashkëpunëtor profesional të profilit të njëjtë, mentor i bashkëpunëtorit profesional mund të jetë bashkëpunëtor profesional i profilit të njëjtë nga shkolla tjetër fillore përkatësisht e mesme në territorin e komunës përkatësisht të Qytetit të Shkupit.

(11) Mentori përgatit program për mbështetje të praktikantit, në bazë të të cilit e udhëzon, i ndihmon, e ndjek punën e praktikantit dhe përgatit raport për përvetësimin e kompetencave themelore profesionale dhe gatishmërinë e tij për dhënie të provimit profesional.

(12) Formën, përmbajtjen dhe elementet e programit përkatësisht raportit nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve me propozim të Byrosë.

(13) I njëjti person mund të jetë në të njëjtën kohë mentor i më së shumti dy praktikantëve.

(14) Për kryerjen e punëve të mentorit, shkolla mentorit i paguan kompensim në lartësi prej 10% të pagës që do ta marrë praktikanti pas mbarimit të stazhit të praktikantit.

(15) Praktikanti pas kalimit të stazhit të praktikantit e jep provim profesional të cilin e organizon Qendra Shtetërore e Provimeve nëpërmjet komisioneve profesionale për realizim të provimit të praktikantit të formuara nga drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve nga radhët e punonjësve të Byrosë, Qendra Shtetërore e Provimeve dhe mësimdhënësit e lëndëve përkatëse mësimore të shkollave fillore përkatësisht e mesme që kanë së paku shtatë vite stazh pune në institucion të verifikuar edukativo-arsimor dhe/ose mësimdhënës nga institucione të akredituara nga sfera përkatëse.

(16) Këshilli i mësimdhënësve, në bazë të raportit për arritjen e kompetencave themelore profesionale të praktikantit dhe përgatitje së tij për dhënie të provimit profesional, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i raportit, miraton propozim për dhënie të provimit profesional ose për vazhdim të stazhit të praktikantit më së shumti në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh me mentor të njëjtë ose tjetër.

(17) Nëse edhe pas stazhit të vazhduar të praktikantit, praktikanti nuk merr mendim pozitiv nga këshilli i mësimdhënësve për dhënie të provimit profesional, i ndërpritet marrëdhënia e punës në shkollë.

(18) Praktikanti e jep provimin profesional vetëm gjatë punësimit të parë si mësimdhënës – praktikant në shkollë.

(19) Mungesa nga puna e praktikantit gjatë dhënies së provimit profesional nuk konsiderohet si mungesë nga puna.

(20) Provimi profesional realizohet në dy afate të provimeve gjatë vitit – afati i provimeve në vjeshtë dhe në pranverë.

(21) Afati i provimeve në vjeshtë zgjat nga 1 tetori deri më 30 nëntor, ndërsa i pranverës në periudhën nga 1 marsi deri më 30 prill.

(22) Praktikanti për dhënie të provimit profesional paguan kompensim, lartësinë e të cilit e përcakton ministri i Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejme: ministri) në bazë të shpenzimeve reale për realizim të provimit profesional. Kompensimi për dhënie të provimit profesional janë të hyra të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

(23) Praktikanti që nuk e jep provimin profesional, mundet sërish të paraqitet dhe ta japë provimin në afatin e ardhshëm të provimit. Nëse nuk e jep provimin profesional edhe në afatin e ardhshëm, i pushon marrëdhënia e punës në shkollë.

(24) Praktikantit që e jep provimin profesional i lëshohet certifikatë për dhënie të provimit profesional në afat prej 15 ditësh nda dita e dhënies së provimit profesional. Certifikatën e lëshon Qendra Shtetërore e Provimeve, ndërsa e nënshkruan drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve. Certifikata lëshohet në tri kopje nga të cilat një kopje i dërrëzohet praktikantit, e dyta dorëzohet në shkollë dhe i bashkëngjitet dosjes së tij personale dhe e treta ruhet në arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve.

(25) Për certifikatat e lëshuara në Qendrën Shtetërore të Provimeve mbahet evidencë elektronike.

(26) Programin për dhënie të provimit profesional të praktikantit, me propozim të Byrosë për Zhvillim të Arsimit (në tekstin e mëtejme: Byroja) dhe Qendrës për Arsim dhe Trajnim Profesional (në tekstin e mëtejme: Qendra), e përcakton ministri.

(27) Mënyrën e përkrahjes së mentorit praktikantit, realizimin e provimit profesional dhe formën e certifikatës për provimin e dhënë profesional i përcakton ministri me propozim të Byrosë, Qendrës dhe Qendrës Shtetërore për Provime.

### **III. MËSIMDHËNËSIT**

### **Neni 3**

(1) Mësimdhënës në shkollë fillore dhe të mesme mund të jetë person i cili:

- ka mbaruar së paku katër vite arsim përkatës të lartë në pajtim me normativin për kuadër arsimor të përcaktuar në programin mësimor dhe ka marrë së paku 240 SEKT. Kualifikimet që i marrin mësimdhënësit për profesionin mësimdhënës në shkollë fillore dhe të mesme i përkasin nivelit VI A të Kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe përkojnë me nivelin VI të Kornizës evropiane të kualifikimeve për arsim të lartë.

- e ka dhënë provimin profesional pas përfundimit të stazhit të praktikantit;
- është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- e njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën dhe alfabetin e gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) alineja 3 e këtij neni mësimdhënës për lëndët në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhë të huaj mund të jetë edhe person shtetas i huaj që ka arsim përkatës të lartë dhe e njeh gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi, për çfarë pajtim jep Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria).

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) alineja 2 e këtij neni, mësimdhënës në shkollë fillore, përkatësisht të mesme mund të jetë edhe personi që nuk e ka dhënë provimin profesional, më së shumti deri në përfundim të vitit shkollor rrjedhës dhe me mentorim të mësimdhënësit-mentor të përcaktuar nga shkolla.

(4) Me përjashtim të paragrafit (1) alineja 1 e këtij neni, në arsim të mesëm profesional, për mësimdhënie praktike, mësimdhënës mund të jenë edhe persona që kanë mbaruar arsim përkatës specialist të shkallës V-të arsimit, përkatësisht arsim përkatës të nivelit V-B, nga Korniza maqedonase e kualifikimeve, ose studime profesionale apo universitare niveli VI-B nga Korniza maqedonase e kualifikimeve, përkatësisht shkallën VI të arsimit, kanë marrë përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodologjike në fakultete përkatëse dhe e kanë dhënë provimin profesional.

(5) Drejtori i shkollës fillore përkatësisht të mesme formon komision që përbëhet prej tre anëtarëve na radhët e kuadrit edukativo-arsimor që kryen kontroll të njohjes së gjuhës të mësimdhënësve nga paragrafi (1) i këtij neni, përveç mësimdhënësve për lëndën gjuhë maqedonase.

(6) Pa provim të dhënë profesional nuk mund të themelohet marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.

### **Neni 4**

(1) Personi i cili ka marrë arsim të lartë në grup jomësimor të studimeve për mësimdhënës, përkatësisht në studime që nuk kanë drejtim mësimor dhe janë të përcaktuara me normativën për kuadër mësimor në programin mësimor, mund të punësohet në shkollë fillore përkatësisht të mesme, përveç se në mësim klasor, vetëm nëse merr përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodike në institucione të akredituara për arsim të lartë.

(2) Përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodike arrihet me ndjekje të mësimit dhe dhënie të provimeve, si dhe realizim të së paku 45 ditësh mësimdhënie praktike në shkollë fillore përkatësisht të mesme në të cilën ligjërohet lënda mësimore për të cilën bëhet përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodike.

(3) Për mësimdhënie praktike nga paragrafi (2) i këtij neni, dhjetë ditë para fillimit me mësimdhënie praktike, personi në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit parashton plan dhe orar për realizim të mësimit praktik, të verifikuar nga institucioni i arsimit të lartë në të cilin bëhet përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodike dhe shkollën në të cilën realizohet mësimi praktik.

(4) Për mësimin e realizuar praktik nga paragrafi (2) i këtij neni personi merr mendim nga mentori në shkollën në të cilën do të realizohet mësimi praktik. Drejtori i shkollës e përcakton mentorin.

(5) Inspektorati Shtetëror i Arsimit kryen kontroll mbi zbatimin dhe realizimin e planit dhe orarit të parashtuar nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Për dhënien e provimeve nga paragrafi (2) i këtij neni kandidati merr 30 kredi sipas SETK.

(7) Akreditim të institucioneve për arsim të lartë që do të realizojnë mësim dhe dhënie të provimeve për përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodike kryen Ministria.

(8) Mënyrën e ndjekjes së mësimin, dhënies së provimeve për përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodike, si dhe mënyrën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë nga paragrafi (7) i këtij neni, i përcakton ministri.

(9) Mësimdhënës në shkolla fillore me qendër resursesh, qendra për përkrahje dhe shkolla shtetërore të mesme për nxënës me pengesa mund të jenë persona me arsim të lartë të kryer në pajtim me nenin 3 paragrafin (1) të këtij ligji, e të cilët kanë mbaruar arsim përkatës për defektologji dhe kanë dhënë provim profesional.

(10) Programet për përgatitje pedagogjike, psikologjike dhe metodike, si dhe për arsim përkatës për defektologji nga paragrafi (2) i këtij neni, i përgatit fakulteti përkatës mësimor, në bashkëpunim me Byronë.

(11) Në shkollë private të mesme, për lëndët për cilat mësimi zhvillohet në gjuhë të huaj, mësimdhënës mund të jenë edhe persona shtetas të huaj që kanë lloj përkatës të arsimit me kushte të pëcaktuara me ligj.

(12) Lartësinë e shpenzimeve për marrje të përgatitjes pedagogjiko-psikologjike dhe metodike nga paragrafi (1) i këtij neni, të institucioneve të akredituara për arsim të lartë, i përcakton ministri në bazë të shpenzimeve reale për përgatitje pedagogjiko-psikologjike dhe metodike.

## **Neni 5**

Ndalohet diskriminim i mësimdhënësve në çfarëdo të baze. Ndalohet torturim trupor dhe psikik i mësimdhënësit.

## **Neni 6**

(1) Mësimin në shkollë fillore përkatësisht të mesme e zhvillojnë mësimdhënësit.

(2) Lloji i përgatitjes profesionale të mësimdhënësve që zhvillojnë punë edukativo-arsimore në shkollë fillore përkatësisht të mesme, është përcaktuar me Normativën për kuadër mësimor të përcaktuar në programet mësimore, të miratuara nga ministri, me propozim të Byrosë përkatësisht Qendrës.

## **Neni 7**

(1) Të punësuarit në shkolla fillore që kryejnë punë nga veprimtaria e arsimit fillor, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në arsim fillor dhe për ata aplikohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat nga Ligji për arsim fillor, dispozitat nga Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- kategoria K – mësimdhënës:

- niveli K1 këshilltar (mësimdhënës- këshilltar, mësimdhënës-këshilltar në shkolla me nxënës me pengesa dhe mësimdhënës-këshilltar në shkolla për mësim të artit që zhvillojnë mësim individual dhe në grupe),

- niveli K2 mentor (mësimdhënës-mentor, mësimdhënës-mentor në shkolla me nxënës me pengesa dhe mësimdhënës-mentor në shkolla për mësim të artit që zhvillojnë mësim individual dhe në grupe),
- niveli K3 mësimdhënës (mësimdhënës, mësimdhënës në shkolla me nxënës me pengesa, mësimdhënës në shkolla për mësim të artit që zhvillojnë mësim individual dhe në grupe) dhe
- niveli K4 praktikant (mësimdhënës-praktikant, mësimdhënës-praktikant në shkolla me nxënës me pengesa, mësimdhënës-praktikant në shkolla për mësim të artit që zhvillojnë mësim individual dhe në grupe).

### **Neni 8**

(1) Të punësuarit në shkollat e mesme që kryejnë punë nga veprimtaria e arsimit të mesëm, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në arsimin e mesëm dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat e Ligjit për arsimin e mesëm, dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni, përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- kategoria Z – mësimdhënës:
- niveli Z1 këshilltar (mësimdhënës-këshilltar, mësimdhënës-këshilltar në shkolla me nxënës me pengesë dhe mësimdhënës-këshilltar në shkolla për mësim të artit që zhvillojnë mësim individual dhe në grupe),
- niveli Z2 mentor (mësimdhënës-mentor, mësimdhënës-mentor në shkolla me nxënës me pengesë dhe mësim në grupe),
- niveli Z3 mësimdhënës (mësimdhënës, mësimdhënës në shkolla me nxënës me pengesa, mësimdhënës në shkolla për mësim të artit që zhvillojnë mësim individual dhe në grupe) dhe
- niveli Z4 praktikant (mësimdhënës-praktikant, mësimdhënës-praktikant në shkolla me nxënës me pengesa, mësimdhënës-praktikant në shkolla për mësim të artit që zhvillojnë mësim individual dhe në grupe).

### **Neni 9**

(1) Mësimdhënësi zgjidhet nëpërmjet konkursit publik dhe themelon marrëdhënie pune në kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor.

(2) Nëse punësimi i mësimdhënësit është në vend ekzistueset punës të liruar në bazë të pensionimit, pushimit mjekësor, dorëheqjes, vdekjes, marrjes ose tjetër, ndërsa për të cilin vend pune janë siguruar mjete financiare, konkursi publik shpallet me pëlqim paraprak të siguruar nga Ministria, për punësim në kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor.

(3) Punësimet për vendet e reja të punës për të cilat është paraqitur nevoja për veprimtari të zgjeruar, numër të zmadhuar të nxënësve ose ndryshime në planin mësimor, konkursi publikohet me pëlqim paraprak të siguruar për punësim në kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor nga Ministria e Financave nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

(4) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, që punësohen në vendin ekzistues të punës së zbrastë në bazë të pensionimit, pushimit mjekësor, largimit nga puna, vdekjes, marrjes e tjetër, e për të cilin vend pune janë paraparë mjete financiare, mund të themelojnë marrëdhënie pune edhe pa konkurs publik, në kohë të caktuar, më së shumti deri në tre muaj, pas pëlqimit të marrë paraprakisht nga kryetari i komunës për shkolla fillore komunale përkatësisht ministri për shkolla fillore shtetërore.

### **Neni 10**

(1) Konkursi publik nga neni 9 paragrafi (1) i këtij ligji, shpallet në së paku dy gazeta zyrtare nga të cilat së paku në një nga gazetatat që botohen në gjuhën maqedonase dhe gazetatat që botohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë të ndryshme zyrtare nga gjuha maqedonase.

(2) Shkolla para shpalljes së konkursit publik për punësim, nevojën e mësimdhënësit për kohë të caktuar e siguron me mësimdhënës me arsim përkatës dhe me fond jo të plotë të orëve nga shkolla tjetër publike në komunë, e për qytetin e Shkupit nga shkolla tjetër publike në komunat në qytetin e Shkupit, pas pëlqimit të marrë paraprakisht për punësim për kohë të caktuar pune nga Ministra.

(3) Kur në konkursin publik nga paragrafi (1) i këtij ligji, paraqiten më tepër kandidatë, përparësi kanë mësimdhënësirt, që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve pasuniversitare.

### **Neni 11**

(1) Nëse në shpalljen publike nga neni 10 paragrafi (1) i këtij ligji, nuk paraqitet personi që i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 3 paragrafi (1), alineja 1 të këtij ligji, mund të themelojë marrëdhënie pune në kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor personi që është paraqitur në shpalljen publike për mësimdhënës.

(2) Mësimdhënësit mund të themelojnë marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar edhe për kohë pune më të shkurtër nga koha e plotë e punës, nëse vëllimi i punës është së paku gjysma nga koha e plotë e punës në javën e punës dhe nuk japin lëndë zgjedhore, në pajtim me ligjin.

(3) Mësimdhënësit që realizojnë mësim dhe kon fond jo të plotë të orëve, mund të themelojnë marrëdhënie pune në kohë të caktuar edhe në shkollë tjetër deri në plotësimin e fondit të plotë të orëve.

### **Neni 12**

(1) Mësimdhënësit i zgjedh drejtori i shkollës me propozim të Këshillit të Shkollës.

(2) Këshilli i Shkollës gjatë përgatitjes së propozimit nga paragrafi (1) i këtij ligji, detyrimisht duhet ta marrë parasysh dispozitën nga neni 10 paragrafi (3) i këtij ligji,

### **Neni 13**

Mësimdhënësit janë të obliguar të punojnë për arritjen e qëllimeve të nënsistemit të arsimit në të cilin punojnë, në pajtim me standardet e përcaktuara nacionale për arritjet e nxënësve, planet mësimore, programet mësimore dhe programin për punë të shkollës.

### **Neni 14**

Detyrat e punës së mësimdhënësit në shkollë i përfshijnë punën edukativo-arsimore dhe lloje tjera të punës profesionale në shkollë:

- planifikim dhe përgatitje të punës edukativo-arsimore dhe lloje tjera të punës profesionale;
- realizim i aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore;
- ndjekje dhe vlerësime të përparimit dhe arritjeve të nxënësve;
- pjesëmarrje në matjet e jashtme të arritjeve të nxënësve (testime ndërkombëtare dhe shtetërore);
- mbajtje të dokumentacionit dhe evidencës pedagogjike;
- bashkëpunim me prindër;
- bashkëpunim me drejtorin, bashkëpunëtorët profesionalë dhe organet tjera të shkollës;
- punë në aktivat profesionale dhe trupat dhe komisionet tjera;

- kryerje të detyrave të kujdestarit të klasës;
- grumbullim dhe përpunim të të dhënave në lidhje me punën edukativo-arsimore dhe tjetër;
- mentorim të nxënësve;
- merr pjesë në realizimin e provimeve të maturës shtetërore, maturës shkollore, provimit përfundimtar, tesimeve shtetërore dhe ndërkombëtare;
- planifikim dhe realizim të zhvillimit profesional;
- realizim të mësimit shtesë dhe plotësues për nxënësit;
- përgatitje dhe udhëheqje të ekskurzioneve, pikniqeve, garave, mësimit në natyrë, pushimeve verore, kampingjeve që i organizon shkolla;
- pjesëmarrje në projekte hulumtuese dhe aktivitete tjera për avancim të punës edukativo-arsimore dhe
- mbajtje të portofolit (pjesë e dosjes profesionale) dhe
- kryerje të punëve tjera të përcaktuara me programin vjetor për punë të shkollës;

### **Neni 15**

(1) Mësimdhënësi ka liri dhe të drejtë ta zgjedhë mënyrën e realizimit të aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore në pajtim me standardet nacionale, planet mësimore, programet mësimore dhe programet e shkollave.

(2) Mësimdhënësi ka të drejtë në mënyrë profesionale të përsoset, të përparojë në karrierë në pajtim me standardet për avancim në titull të cilat i përcakton ministri me propozim të Byrosë.

(3) Mësimdhënësi ka të drejtë për kushte adekuate pune në shkollë në pajtim me normat dhe standardet e përcaktuara për zhvillim të mësimit.

(4) Mësimdhënësi ka të drejtë të marrë pjesë në organet udhëheqëse të shkollës, të njëjtat t'i zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur.

(5) Mësimdhënësi ka të drejtë për mbrojtje nga keqpërdorimi dhe mobingu, diskriminimi, dhuna dhe shqetësimi fizik, seksual dhe psikik.

### **Neni 16**

(1) Mësimdhënësi e zhvillon mësimin në pajtim me kompetencat profesionale për mësimdhënës.

(2) Mësimdhënësi e zhvillon mësimin dhe aktivitetet jashtëmësimore me përfshirje aktive të nxënësve dhe me shfrytëzim të teknologjisë bashkëkohore mësimore.

### **Neni 17**

(1) Orari i punës së mësimdhënësit është 40 orë pune në javë nga të cilat 20 deri 23 orë mësimore.

(2) Në fondin javor të orëve në mësim nga paragrafi (1) i këtij neni nuk bëjnë pjesë orët për mësim shtesë dhe plotësues.

(3) Në 40 orët e punës në javë, mësimdhënësi është i obliguar të ketë 5 orë punë të drejtpërdrejtë javore me nxënës në mësim shtesë, plotësues dhe aktivitete jashtëmësimore.

(4) Për mësimdhënësit në arsim fillor, në 40 orë pune në javë bën pjesë edhe koha për pranim të organizuar të nxënësve para dhe pas mësimit.

(5) Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës dhe shfrytëzimi i pushimit ditor dhe vjetor të personave nga paragrafi (1), përcaktohet me statutin e shkollës.

(6) Mbajtjen e bazës së integruar të të dhënave (ECAPY), mbajtjen e ueb-faqes së shkollës dhe obligimet tjera në lidhje me punën kompjuterike në shkollë i kryen mësimdhënësi i lëndës mësimore, për çfarë fiton tri orë mësimi nga fondi i orëve, nëse shkolla ka deri 400 nxënës, përkatësisht gjashtë orë mësimi për shkollë deri në 1000 nxënës dhe tetë orë mësimi për shkollë me mbi 1000 nxënës.

(7) Mësimdhënësin nga paragrafi (6) i këtij neni e përcakton drejtori nga radhët e mësimdhënësve në shkollën, për vendin e punës së të cilit janë siguruar mjete financiare, e të cilët nuk kanë fond të plotë të orëve mësimore.

(8) Mënyrën dhe vëllimin e detyrave të punës në suazat e orarit të punës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë gjatë javës 40 orëshe të punës, i përcakton ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

### **Neni 18**

(1) Mësimdhënësi përkatësisht bashkëpunëtori profesional që tregon rezultate të jashtëzakonshme në punën dhe afirmimin e shkollës dhe profesionit mund të jetë i lavdëruar dhe/ose i shpërblyer në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga komuna, komuna në qytetin e Shkupit, përkatësisht qyteti i Shkupit, ndërsa për shkollat shtetërore nga Ministria.

(2) Vendim për lavdëratë dhe/ose shpërblim merr këshilli i shkollës me propozim të këshillit të mësimdhënësve, e me mendim paraprak të marrë nga komuniteti i nxënësve, këshilli i prindërve dhe drejtori i shkollës.

(3) Mjetet për shpërblime i siguron shkolla ose komuna, komuna në qytetin e Shkupit, përkatësisht qyteti i Shkupit, ndërsa për shkollat shtetërore i siguron Ministria.

### **Neni 19**

(1) Punën e mësimdhënësve e ndjek drejtori dhe Byroja përkatësisht Qendra në suazat e kompetencave të tyre.

(2) Për mësimdhënësit të cilët në realizimin e procesit edukativo-arsimor nuk tregojnë rezultate të mjaftueshme ose në mënyrë të rëndë i cenojnë standardet e sjelljes profesionale, Byroja, Qendra, këshilli i prindërve ose Inspektorati Shtetëror i Arsimit parashtrajnë iniciativë në këshillin shkollor për rishqyrtim të punës së mësimdhënësit.

(3) Standardet për sjellje profesionale nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton Ministria me propozim të Byrosë.

(4) Nëse shkaqet për rezultate të pamjaftueshme nuk janë kushtet objektive në shkollë dhe organizimin e punës në shkollë, këshilli shkollor merr vendim që mësimdhënësit t'i përcaktohet ndihmë shtesë profesionale.

(5) Ndhima plotësuese profesionale i përcaktohet mësimdhënësit për të cilin janë siguruar informata që: nuk arrin të mbajë disiplinë të punës në klasë, nuk përdor metoda efektive për mësim dhe komunikim me nxënësit dhe prindërit, nuk i ndjek dhe vlerëson arritjet e nxënësve në pajtim me standardet e vendosura për vlerësim në programet mësimore.

(6) Programin për ndihmë shtesë profesionale e përgatit ekipi për zhvillim profesional në bashkëpunim me Byronë përkatësisht Qendrën.

(7) Programi mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj.

(8) Realizimin e programit e ndjek drejtori i shkollës dhe në çdo tre muaj e informon këshillin shkollor për realizimin e të njëjtit dhe rezultatet e arritura.

(9) Nëse mësimdhënësi nuk u përmbahet rekomandimeve të programit dhe nuk e realizon programin për ndihmë shtesë profesionale, drejtori, me propozim të këshillit të shkollës, merr aktvendim për zvogëlim të pagës në shumë prej 1/3 nga paga e fundit e paguar e mësimdhënësit para marrjes së aktvendimit.

(10) Nëse mësimdhënësi edhe në gjashtë muajt e ardhshëm nuk u përmbahet rekomandimeve të programit dhe nuk e realizon programin për ndihmë shtesë profesionale, drejtori, me propozim të këshillit të shkollor, merr aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës së mësimdhënësit.

(11) Kundër aktvendimeve nga paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni, mësimdhënësi ka të drejtë ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në



Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

(12) Për mësimdhënës i cili nuk e respekton orarin e punës dhe bën shkelje të rënda të Kodit etik për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë ngritet procedurë disiplinore.

(13) Kodin etik për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë e miraton këshilli shkollor i shkollës.

(14) Procedurën disiplinore e zbaton komisioni disiplinor në mënyrë të përcaktuar me statutin e shkollës.

(15) Drejtori, në bazë të propozimit të komisionit disiplinor, merr aktvendim për shqiptim të masës disiplinore.

(16) Në rastet e shkeljeve më të rënda të Kodit Etik për mësimdhënës dhe bashkëpunëtor profesionalë, deri në miratim të aktvendimit nga paragrafi (15) i këtij neni, drejtori me aktvendim mund ta largojë mësimdhënësin nga puna më së shumti deri në tre muaj periudhë për të cilën mësimdhënësi merr pagë në shumë prej 50% nga rroga e fundit e paguar para se të largohet nga puna.

(17) Mësimdhënësi, kundër aktvendimit të marrë nga paragrafi (15) i këtij neni dhe aktvendimit nga paragrafi (16) të këtij neni ka të drejtë ankese në Këshillin Shkollor, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit nga paragrafi (15) i këtij neni, përkatësisht aktvendimit nga paragrafi (16) i këtij neni.

(18) Nëse ekziston dyshim i bazuar që mësimdhënësit i është çrregulluar shëndeti mental, përkatësisht për shkak të sëmundjeve ose rrethanave tjera të cilat në çfarëdo mënyre mund ta pamundësojnë ose thelbësisht ta kufizojnë gjatë kryerjes së obligimeve, ose mund t'ia rrezikojnë shëndetin ose jetën e të punësuarve tjerë dhe nxënësve gjatë kryerjes së obligimeve të veta, drejtori detyrimisht e udhëzon mësimdhënësin në kontroll të jashtëzakonshëm në komision mjekësor për rishqyrtim të aftësisë për realizim të obligimeve të punës në institucion kompetent shëndetësor.

(19) Mësimdhënësi që është dërguar në kontroll të jashtëzakonshëm në komision mjekësor, nga paragrafi (18) i këtij neni, nuk ka të drejtë ta refuzojë udhëzimin për kontroll të jashtëzakonshëm në komision mjekësor.

(20) Nëse mësimdhënësi e refuzon udhëzimin për kontroll të jashtëzakonshëm në komision mjekësor nga paragrafi (18) i këtij neni, i ndërpritet marrëdhënia e punës me fuqi të këtij ligji.

### **Neni 20**

(1) Mësimdhënësit për punën e të cilit ka pushuar nevoja për shkaqe të punës, nuk mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës derisa nuk i sigurohet një nga të drejtat në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

(2) Mënyra dhe kriteret për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkaqe të punës përcaktohen me marrëveshje kolektive.

### **Neni 21**

(1) Gjatë ndryshimeve në vëllimin e punës në shkollën publike që paraqiten për shkak të ndryshimeve në planet dhe programet, organizimin e punës, numrin e paraleleve dhe ndryshime tjera, marrëdhënia e punës së mësimdhënësit ndryshohet nga marrëdhënia e punës në kohë të pacaktuar me orar të plotë pune në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me orar më të shkurtër pune dhe anasjelltas.

(2) Drejtori është i obliguar që në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni me mësimdhënësin të lidhë marrëveshje të re për punë, në afat prej shtatë ditësh nga dita e ndodhjes së ndryshimeve nga paragrafi (10) i këtij neni.

### **Neni 22**

(1) Mësimdhënësit i cili ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në shkollë fillore përkatësisht të mesme i pezullohet marrëdhënia e punës në shkollë

nëse regjistrohet në cikël të dytë, përkatësisht të tretë të studimeve në institucion të arsimit të lartë nga fusha e arsimit të mësimdhënësve, që është i ranguar ndër 200 institucionet e para të arsimit të lartë në listën që e përgatit Qendra për klasë botërore të universiteteve pranë Xhiao Tong Universitetit të Shangait nga Republika Popullore e Kinës, ose në universitet që është në rang listën e universiteteve nga fusha e arsimit, që e përgatit Quacquarelli Symonds (QS) nga Britania e Madhe.

(2) Mësimdhënësi nga paragrafi (1) i këtij neni ka të drejtë, që në afat prej 15 ditësh nga dita e përfundimit të arsimit në institucion të arsimit të lartë nga paragrafi (1) i këtij neni, të kthehet në punë në shkollë në të cilën ka themeluar marrëdhënie pune, për kryerjen e punëve që përputhen me llojin dhe shkallën e përgatitjes së tij profesionale.

#### **IV. KOMPETENCA THEMELORE PROFESIONALE TË MËSIMDHËNËSVE**

##### **Neni 23**

(1) Mësimdhënësi duhet t'i posedojë kompetencat themelore profesionale për mësimdhënës për të realizuar mësim në shkollë fillore përkatësisht të mesme.

(2) Kompetencat themelore profesionale kanë të bëjnë me dituritë, shkathtësitë dhe vlerat profesionale që janë të domosdoshme për kryerje cilësore të punës edukativo-arsimore.

(3) Mësimdhënësi i fiton kompetencat themelore profesionale gjatë arsimimit për mësimdhënës dhe gjatë stazhit të praktikantit.

##### **Neni 24**

(1) Kompetencat themelore profesionale përfshijnë dituri, shkathtësi dhe vlera profesionale, në këto fusha:

1. Dituri për lëndën mësimore dhe për sistemin edukativo-arsimor;
2. Mësimdhënie dhe mësimnxënie (planifikimi dhe përgatitja e mësimit, realizimi i mësimit, vlerësimi i nxënësve, njohja e nxënësve dhe ndihmesa për nevojat e tyre);
3. Krijimi i mjedisit stimulativ për mësimnxënie (krijim të mjedisit të sigurtë dhe stimulues për mësimnxënie dhe klimë pozitive shkollore);
4. Inkluzion social dhe arsimor;
5. Komunikim dhe bashkëpunim me familjen dhe bashkësinë dhe
6. Zhvillim profesional dhe bashkëpunim profesional.

(2) Kompetencat themelore profesionale nga fushat nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

#### **V. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE**

##### **Neni 25**

(1) Mësimdhënësit gjatë punës së tyre janë të obliguar në vazhdimësi të përsosjen profesionalisht.

(2) Ministri miraton program vjetor për trajnime për përsosje profesionale të mësimdhënësve deri në fund të muajit janar në vitin rrjedhës.

(3) Propozim-programin për trajnime për përsosje profesionale e përpilon dhe propozon Byroja në bashkëpunim me Qendrën dhe Inspektoratin Shtetëror të Arsimit.

##### **Neni 26**

(1) Përsosja profesionale e mësimdhënësve realizohet nëpërmjet programeve të akredituara për trajnim, nëpërmjet projekteve të miratuara nga Ministria, përsosjes interne profesionale në shkollë, ekipeve ndërshkollore për mësimnxënie dhe nëpërmjet formave individuale të mësimit.

(2) Përsosja profesionale nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet pa u cenuar procesi edukativo-arsimor në shkollë, për çfarë kujdeset drejtori i shkollës.

#### **Neni 27**

(1) Mësimdhënësit janë të obliguar në suazat e përsosjes së vazhdueshme profesionale të kalojnë së paku 60 orë në trajnime gjatë tri viteve shkollore.

(2) Në suazat e trajnimeve nga paragrafi (1) i këtij neni së paku 40 orë janë nga pjesëmarrja në programe të akredituara për trajnim.

(3) Mjetet për trajnime nga paragrafi (2) sigurohet në buxhetin e Byrosë, njësia e vetëqeverisjes lokale dhe nëpërmjet projekteve arsimore të miratuara prej Ministrisë.

(4) Akreditimi i programeve për trajnim nga paragrafi (2) i këtij neni kryhet në pajtim me Ligjin për Byronë për Zhvillim të Arsimit.

(5) Çdo mësimdhënës në afat prej tre viteve kalon 20 orë trajnim për programe prioritare të përcaktuara prej ministrit për çfarë mjetet sigurohen në buxhetin e Byrosë.

#### **Neni 28**

(1) Për përsosjen individuale profesionale mësimdhënësi bën plan personal për zhvillim profesional për çdo vit shkollor në bazë të vetevaluimit lidhur me kompetencat profesionale, rezultatet nga evaluimi integral dhe raporte e vizitave të drejtorit të shkollës, këshilltarëve të Byrosë, Qendrës dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

(2) Planin nga paragrafi (1) të këtij neni e miraton drejtori i shkollë me propozim të ekipit për zhvillim profesional në shkollë.

(3) Ekipin për zhvillim profesional e përbëjnë koordinatorët e aktivëve profesionalë të mësimdhënësve në shkollë, drejtori dhe bashkëpunëtori profesional në shkollë.

(4) Formën e planit personal për zhvillim profesional të mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit profesional i rregullon ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

#### **Neni 29**

(1) Mësimdhënësi, i cili për shkaqe objektive nuk mund të realizojë pjesë të aktiviteteve të planifikuara në planin personal për zhvillim profesional nga neni 28 paragrafi (1) i këtij ligji, ka të drejtë, në konsultim me drejtorin e shkollës të bëjë ndryshim në planin personal për zhvillim profesional.

(2) Mësimdhënësit që nuk e ka realizuar planin personal për zhvillim profesional, e për këtë nuk ka shkaqe objektive, drejtori vitin e ardhshëm shkollor i përcakton zhvillim të përkrahur profesional.

(3) Zhvillim i përkrahur profesional nga paragrafi (2) i këtij neni, nënkupton caktim të mësimdhënësit në titull më të lartë ose mësimdhënësit tjetër që i ndihmon mësimdhënësit në përpunimin dhe realizimin e planit të tij personal për zhvillim profesional të mësimdhënësit.

#### **Neni 30**

(1) Për zhvillimin profesional të secilit mësimdhënës mbahet dosje profesionale.

(2) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së dosjes profesionale të mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit profesional i rregullon ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

## **VI. ZHVILLIMI I KARRIERËS SË MËSIMDHËNËSVE**

#### **Neni 31**

Mësimdhënësit në shkollat fillore dhe të mesme mund të përparojnë në tituj.

### **Neni 32**

(1) Kategoria mësimdhënës fitohet me dhënie të provimit profesional për mësimdhënës.

(2) Mësimdhënësi mund të përparojë në titujt mësimdhënës-mentor dhe mësimdhënës-këshilltar.

(3) Standardet profesionale për titujt mësimdhënës-mentor dhe mësimdhënës-këshilltar dhe mënyrën e marrjes i përcakton ministri me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

(4) Numrin e mësimdhënësve që mund t'i fitojnë titujt mësimdhënës-mentor ose mësimdhënës-këshilltar për çdo komunë, komunë në Qytetin e Shkupit, përkatësisht Qytetin e Shkupit për çdo vit fiskal e përcakton ministri, pas pëlqimit paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **Neni 33**

(1) Mësimdhënësi mund të përparojë në titull mësimdhënës-mentor nëse:

- ka së paku shtatë vjet përvojë pune si mësimdhënës,
- është i punësuar në kohë pune të pacaktuar dhe
- i plotëson standardet profesionale për mësimdhënës-mentor,

(2) Kërkesa për avancim në titull mësimdhënës-mentor parashtrohet në Ministri pas thirrjes së shpallur publike, nëpërmjet aplikacionit elektronik në faqen e internetit të Ministrisë, me këtë dokumentacion:

- diplomë ose certifikatë për arsim përkatës të mbaruar ose kopje të verifikuar në noter,

- dëshmi për plotësim të standardeve profesionale për mësimdhënës-mentor nga dëshmitë e përfshira në dosjen profesionale të mësimdhënësit,

- vlerësim nga Byroja përkatësisht Qendra dhe mendim nga shkolla për plotësim të standardeve për mësimdhënës-mentor dhe

- raport nga Fondi për Sigurim Pensional dhe linvalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për stazh pune të realizuar të mësimdhënësit,

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni e përcakton ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

(4) Komisioni nga neni 35 paragrafi (1) i këtij ligji është i obliguar ta përgatitë rang-listën nga neni 35 paragrafi (3) i këtij ligji, në afat prej 90 ditësh nga dita e kompletimit të dokumentacionit nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Nëse kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni, është dorëzuar pa dokumentacion të kompletuar, parashtruesi i kërkesës njoftohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me dokumentacion.

(6) Parashtruesi i kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni, obligohet ta kompletojë dokumentacionin në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni.

### **Neni 34**

(1) Mësimdhënësi-mentor mund të përparojë në titull mësimdhënës-këshilltar nëse:

- ka së paku dhjetë vite përvojë pune, nga të cilat tri vite në titullin mësimdhënës-mentor dhe

- i plotëson standardet profesionale për mësimdhënës-këshilltar,

(2) Kërkesa për avancim në titull mësimdhënës-mentor parashtrohet në Ministri pas thirrjes së shpallur publike, nëpërmjet aplikacionit elektronik në faqen e internetit të Ministrisë me këtë dokumentacion:

- dëshmi për titull të fituar mësimdhënës-mentor,

- dëshmi për plotësim të standardeve profesionale për mësimdhënës-mentor nga dëshmitë e përfshira në dosjen profesionale të mësimdhënësit,

- vlerësim nga Byroja përkatësisht Qendra dhe mendim nga shkolla për plotësim të standardeve për mësimdhënës-mentor dhe

- raport nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për stazh pune të realizuar të mësimdhënësit,

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

(4) Komisioni nga neni 35 paragrafi 1 i këtij ligji është i obliguar ta përgatitë rang-listën nga neni 35 paragrafi (3) i këtij ligji, në afat prej 90 ditësh nga dita e kompletimit të dokumentacionit nga paragrafi (2) i këtij neni.

### **Neni 35**

(1) Plotësimin e standardeve profesionale për titujt mësimdhënës-mentor dhe mësimdhënës-këshilltar e kontrollojnë komisione të formuara nga ministri.

(2) Komisionet nga paragrafi (1) i këtij neni përbëhen nga: një përfaqësues nga fakultetet përkatës të mësimdhënësve, një përfaqësues nga sindikata reprezentative e arsimit, një përfaqësues nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe nga një përfaqësues nga Ministria, Byroja përkatësisht Qendra për mësimdhënësit e lëndëve profesionale.

(3) Komisioni i vlerëson aplikacionet dhe dokumentacionin e arritur të mësimdhënësve për të marrë titullin mësimdhënës-mentor dhe mësimdhënës-këshilltar dhe në pajtim me pikët e fituara të kandidatëve përgatit rang listë. Mësimdhënësit me rangim më të lartë, sipas numrit të përcaktuar nga ministri për atë vit, e marrin titullin mësimdhënës-mentor, përkatësisht mësimdhënës-këshilltar.

(4) Mësimdhënësi i cili nuk do të jetë i kënaqur me vlerësimin nga komisioni ka të drejtë ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vlerësimit të komisionit.

(5) Mënyrën e formimit të komisioneve dhe numrin e tyre, vlerësimin e aplikacioneve dhe dokumentacionit të pranuar të mësimdhënësve për të marrë titullin mësimdhënës-mentor dhe mësimdhënës-këshilltar, vlerësimin e kandidatëve me pikë, rang- listën, si dhe mënyrën e punës së komisionit i përcakton ministri me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

### **Neni 36**

(1) Mësimdhënësit, pa procedurë të zbatuar për rishqyrtim të titullit të marrë, i hiqet titulli i marrë, nëse:

- me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar masa ndalim për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe

- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë muajsh.

(2) Procedurë për rishqyrtim të titullit të marrë inicion shkolla nëse:

- mësimdhënësi ka ndërprerje të vazhdueshme të marrëdhënies së punës ose pezullim të marrëdhënies së punës në institucion edukativo-arsimor më tepër se tri vite,

- nuk e realizon planin për zhvillim personal profesional dhe si rezultat i kësaj mësimdhënësit i është caktuar zhvillim i përkrahur profesional në periudhë të caktuar kohore dhe

- nuk i realizon detyrat e punës të mësimdhënësit-mentor përkatësisht mësimdhënësit-këshilltar.

(3) Procedurë për rishqyrtim të titullit të fituar nuk inicohet nëse mësimdhënësi ka ndërprerje të vazhdueshme të marrëdhënies së punës në institucion edukativo-

arsimor më shumë se tri vite në pajtim me nenin 22 të këtij ligji si dhe për shkak të dërgimit për përsosje profesionale nga punëdhënësi.

(4) Iniciativë për heqje të titujve të fituar ngrit drejtori i shkollës në të cilën punon mësimdhënësi, Byroja, Qendra ose Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe dorëzohet në Ministri në afat prej shtatë ditësh nga dita e ngritjes së iniciativës.

(5) Ministri në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së iniciativës nga paragrafi (4) i këtij neni, formon Komision për marrjen dhe rishqyrtimin e titujve të mësimdhënësve, të formuar nga tre anëtarë, nga të cilët njëri është nga radha e të punësuarve në Byro, përkatësisht Qendra për mësimdhënës të lëndëve profesionale, një nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe një nga Sindikata Reprezentative për Arsim.

(6) Komisioni jep propozim për heqje të titullit ose propozim për refuzim të iniciativës nga paragrafi (4) i këtij neni, te ministri në afat prej 30 ditësh nga dita e formimit të tij.

(7) Ministri në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së propozimit nga paragrafi (6) i këtij neni miraton aktvendim.

(8) Kundër aktvendimit të ministrit nga paragrafi (7) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

### **Neni 37**

Detyrat e punës së mësimdhënësve me titull mësimdhënës-mentor, përveç obligimeve nga neni 14 i këtij ligji, përfshijnë edhe:

- mentorim për mësimdhënës-praktikant;
- mentorim për studentë nga fakultetet për mësimdhënës;
- mentorim për mësimdhënës që kanë zhvillim të përkrahur profesional;
- shfrytëzim të qasjeve inovuese dhe u ndihmon kolegëve në zbatimin e hulumtimeve aksionale;
- pjesëmarrje në përpilim të politikave zhvillimore të shkollës dhe
- detyra tjera në pajtim me kompetencat e marra për mësimdhënës-mentor.

### **Neni 38**

Detyrat e punës të mësimdhënësve me titull mësimdhënës-mentor, përveç obligimeve nga neni 14 i këtij ligji, përfshijnë edhe:

- mentorim për studentë nga fakultetet për mësimdhënës;
- mentorim të kolegëve që kanë zhvillim të përkrahur profesional;
- udhëheqje të ekipeve ndërshkollore për mësimnxënie;
- përgatitje të materialeve mësimore për mësimnxënie;
- krijim, aplikim dhe zbatim të projekteve inovuese në shkollë;
- pjesëmarrje në përpilim të politikave zhvillimore të shkollës dhe
- detyra tjera në pajtim me kompetencat e marra për mësimdhënës-këshilltar.

## **VII. BASHKËPUNËTORË PROFESIONALË**

### **Neni 39**

(1) Bashkëpunëtor profesional në arsim fillor dhe të mesëm (pedagog, psikolog, edukator special dhe rehabilitues, sociolog, punonjës social, bibliotekar etj.) mund të jetë person i cili:

- ka mbaruar së paku katër vite arsim përkatës të lartë dhe ka marrë së paku 240 SETK;
- është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- e njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën dhe alfabetin e gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi.

(2) Kualifikimet të cilat i fitojnë bashkëpunëtorët profesionalë për profesionin bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore dhe të mesme i përkasin nivelit VI A të Kornizës maqedonase të kualifikimeve të arsimit të lartë dhe përshtaten me nivelin VI të Kornizës evropiane të kualifikimeve për arsim të lartë.

(3) Lloji i përgatitjes profesionale të bashkëpunëtorëve profesionalë në arsim fillor përkatësisht të mesëm është i përcaktuar me Normativën për bashkëpunëtor profesionalë në arsim fillor përkatësisht të mesëm, të përcaktuar nga minsitri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

(4) Drejtori i shkollës fillore përkatësisht të mesme formon komision që përbëhet prej tre anëtarëve nga radhët e kuadrit edukativo-arsimor që kryen kontroll të njohjes së gjuhës të bashkëpunëtorëve profesionalë nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Pa provim të dhënë profesional nuk mund të themelohet marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar.

#### **Neni 40**

(1) Bashkëpunëtori profesional zgjidhet me konkurs publik.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të themelojnë marrëdhënie të punës edhe pa konkurs publik, në kohë të caktuar, më së shumti deri në tre muaj.

(3) Konkursi publik nga paragrafi (1) i këtij neni publikohet në së paku dy gazeta ditore nga të cilat së paku në nga një prej gazetave që shtypen në gjuhë maqedonase dhe në gazetatat që shtypen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(4) Kur në konkursin publik nga paragrafi (1) do të paraqiten më tepër kandidatë, përparësi kanë bashkëpunëtorët profesionalë, të cilët kanë shkallë më të lartë të arsimit përkatës të lartë, sukses më të lartë gjatë studimeve universitare.

(5) Gjatë zgjedhjes së bashkëpunëtorëve profesionalë zbatohet parimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat i qytetarëve që u përkasin të gjitha bashkësive dhe respektimi i kriterëve për profesionalizëm dhe kompetencë.

#### **Neni 41**

(1) Bashkëpunëtorët profesionalë i zgjedh drejtori i shkollës me propozim të Këshillit të Shkollës.

(2) Këshilli i Shkollës gjatë përgatitjes së propozimit nga paragrafi (1) i këtij neni, detyrimisht duhet ta marrë parasysh dispozitën nga neni 40 paragrafi (4) i këtij ligji.

#### **Neni 42**

Bashkëpunëtorët profesionalë janë të obliguar të punojnë në arritjen e qëllimeve të nënsistemit të arsimit në të cilin punojnë, në pajtim me programin për punë të shkollës dhe udhëzimet për punë të bashkëpunëtorëve profesionalë të përgatitura prej Byrosë.

#### **Neni 43**

Ndalohet diskriminim i bashkëpunëtorëve profesionalë në çfarëdo baze. Ndalohet torturimi trupor ose psikik i bashkëpunëtorit profesional.

#### **Neni 44**

(1) Detyrat e punës së bashkëpunëtorit profesional në arsim fillor dhe të mesëm përfshijnë punë profesionale në pajtim me kompetencat themelore profesionale për bashkëpunëtorë profesionalë.

(2) Kompetencat themelore profesionale bashkëpunëtor profesional përfshijnë vlera profesionale dhe dituri e shkathtësi profesionale, në këto fusha:

- punë me nxënës,
- punë me mësimdhënës,

- punë me prindër,
- bashkëpunim me komunitetin,
- zhvillim profesional dhe bashkëpunim profesional,
- punë analitiko-hulumtuese dhe
- strukturë, organizim dhe klimë shkollore.

(3) Kompetencat themelore profesionale nga fushat nga paragrafit (2) i këtij neni i përcakton ministri, me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

#### **Neni 45**

Bashkëpunëtori profesional ka të drejtë:

- në mënyrë profesionale të përsoset dhe të përparojë në karrierë në pajtim me standardet për avancim në titull;
- për kushte adekuate pune në shkollë në pajtim me normat dhe standardet e përcaktuara;
- të marrë pjesë në organet udhëheqëse të shkollës, të njëjtat t'i zgjedh dhe të jetë i zgjedhur dhe
- për mbrojtje nga keqpërdorimi dhe mobingu, diskriminimi, dhuna dhe shqetësimi fizik, seksual dhe psikik.

#### **Neni 46**

(1) Bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore që kryejnë punë nga veprimtaria e arsimit fillor, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në arsim fillor dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- kategoria LL – bashkëpunëtor profesional
- niveli LL1 – këshilltar (bashkëpunëtor profesional- këshilltar, bashkëpunëtor profesional - këshilltar në shkolla me nxënës me pengesa),
- niveli LL2 mentor (bashkëpunëtor profesional-mentor, bashkëpunëtor profesional – mentor në shkolla me nxënës me pengesa),
- niveli LL3 bashkëpunëtor profesional (bashkëpunëtor profesional, bashkëpunëtor profesional në shkolla me nxënës me pengesa) dhe
- niveli LL4 praktikant (bashkëpunëtor profesional-praktikant, bashkëpunëtor profesional –praktikant në shkolla me nxënës me pengesa).

#### **Neni 47**

(1) Bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat e mesme kryejnë punë nga veprimtaria e arsimit, kanë status të dhënësve të shërbimeve publike në arsim të mesëm dhe për ata zbatohen dispozitat e këtij ligji, dispozitat nga sfera e të punësuarve në sektorin publik dhe rregullat e përgjithshme për marrëdhënie të punës.

(2) Për të punësuarit nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen këto kategori dhe nivele të vendeve të punës:

- kategoria I – bashkëpunëtor profesional
- niveli I1 – këshilltar (bashkëpunëtor profesional - këshilltar, bashkëpunëtor profesional - këshilltar në shkolla me nxënës me pengesa),
- niveli I2 mentor (bashkëpunëtor profesional-mentor, bashkëpunëtor profesional – mentor në shkolla me nxënës me pengesa),
- niveli I3 bashkëpunëtor profesional (bashkëpunëtor profesional, bashkëpunëtor profesional në shkolla me nxënës me pengesa) dhe
- niveli I4 praktikant (bashkëpunëtor profesional - praktikant, bashkëpunëtor profesional -praktikant në shkolla me nxënës me pengesa).



### **Neni 48**

Bashkëpunëtori profesional me dhënie të provimit për praktikant merr kompetencat themelore për bashkëpunëtor profesional në shkollë.

### **Neni 49**

Orari i punë së bashkëpunëtorit profesional në shkollë fillore gjatë javës është 40 orë.

### **Neni 50**

(1) Punën e bashkëpunëtorëve profesionalë e ndjek drejtori dhe Byroja përkatësisht Qendra në suazat e kompetencave të tyre.

(2) Për bashkëpunëtorët profesionalë të cilët në realizimin e punës së tyre nuk tegrojnë rezultate të mjaftueshme ose më rëndë i cenon standardet e sjelljes profesionale, Byroja, Qendra, këshilli i prindërve ose Inspektorati Shtetëror i Arsimit parashtrojnë iniciativë në Këshillin Shkollor për rishqyrtim të punës së bashkëpunëtorit profesional.

(3) Standardet për sjellje profesionale nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton sindikata reprezentative e mësimdhënësve.

(4) Nëse shkaqet për rezultate të pamjaftueshme nuk janë kushtet objektive në shkollë dhe organizimi i punës në shkollë, këshilli shkollor merr vendim që bashkëpunëtorit profesional t'i përcaktohet ndihmë plotësuese profesionale.

(5) Ndihma plotësuese profesionale i përcaktohet bashkëpunëtorit profesional për të cilin janë siguruar njohuri se: nuk përdor metoda efektive komunikimi me nxënësit dhe prindërit, nuk u jep mbështetje mësimdhënësve, përkatësisht nuk i kryen detyrat e tij në pajtim me kompetencat e përcaktuara themelore profesionale.

(6) Programin për ndihmë shtesë profesionale e përgatit ekipi për zhvillim profesional në bashkëpunim me Byronë përkatësisht Qendrën.

(7) Programi mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj.

(8) Realizimin e programit e ndjek drejtori i shkollës dhe në çdo tre muaj e informon këshillin shkollor për realizimin e të njëjtit dhe rezultatet e arritura.

(9) Nëse bashkëpunëtori profesional nuk u përmbahet rekomandimeve në programin për ndihmë shtesë profesionale dhe nuk e realizon programin për ndihmë shtesë profesionale, drejtori, me propozim të këshillit shkollor, merr aktvendim për zvogëlim të pagës në shumë prej 1/3 nga paga e fundit e paguar e bashkëpunëtorit profesional para marrjes së aktvendimit.

(10) Nëse bashkëpunëtori profesional edhe në gjashtë muajt e ardhshëm nuk u përmbahet rekomandimeve në program dhe nuk e realizon programin për ndihmë shtesë profesionale, drejtori me propozim të këshillit të shkollor, merr aktvendim për ndërprerje të marrëdhënies së punës të bashkëpunëtorit profesional.

(11) Për bashkëpunëtorin profesional i cili nuk e respekton orarin e punës dhe bën shkelje më të rënda të Kodit etik për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë ngritet procedurë disiplinore.

(12) Procedurën disiplinore e zbaton Komisioni Disiplinor në mënyrën e përcaktuar me statutin e shkollës.

(13) Drejtori, në bazë të propozimit të komisionit disiplinor, merr aktvendim për shqiptim të masës disiplinore.

(14) Në rastet e shkeljeve më të rënda të Kodit Etik për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë, deri në miratim të aktvendimit nga paragrafi (14) i këtij neni, drejtori me aktvendim mund ta largojë bashkëpunëtorin profesional nga puna.

(15) Bashkëpunëtori profesional, kundër aktvendimit të marrë nga paragrafi (13) i këtij neni dhe aktvendimit nga paragrafi (14) i këtij neni ka të drejtë ankese në Këshillin Shkollor, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit nga paragrafi (13) i këtij neni, përkatësisht aktvendimit nga paragrafi (14) i këtij neni.

(16) Nëse ekziston dyshim i bazuar që bashkëpunëtorit profesional i është çrregulluar shëndeti mental përkatësisht për shkak të sëmundjeve ose rrethanave tjera të cilat në çfarëdo mënyre mund ta pamundësojnë ose thelbësisht ta kufizojnë gjatë kryerjes së obligimeve, ose mund t'ia rrezikojnë shëndetin ose jetën e të punësuarve tjerë dhe nxënësve gjatë kryerjes së obligimeve të veta, drejtori detyrimisht e udhëzon bashkëpunëtorin profesional në kontroll të jashtëzakonshëm në komision mjekësor për rishqyrtim të aftësisë për realizimin e obligimeve të punës në institucion kompetent mjekësor.

(17) Bashkëpunëtori profesional që është dërguar në kontroll të jashtëzakonshëm në komision mjekësor nga paragrafi (16) i këtij neni, nuk ka të drejtë ta refuzojë udhëzimin në kontroll të jashtëzakonshëm mjekësor.

(18) Nëse bashkëpunëtori profesional e refuzon dërgimin në kontroll të jashtëzakonshëm në komision mjekësor nga paragrafi (16) i këtij neni, i ndërpritet marrëdhënia e punës me fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 51**

(1) Bashkëpunëtorit profesional për punën e të cilit ka pushuar nevoja për shkaqe të punës, nuk mund t'i ndërpritet marrëdhënia e punës derisa nuk i sigurohet një nga të drejtat në pajtim me ligjin dhe marrëveshje kolektive.

(2) Mënyra dhe kriteret për ndërprerje të marrëdhënies së punës për arsye të punës përcaktohen me marrëveshje kolektive.

### **VIII. ZHVILLIMI PROFESIONAL I BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONALË**

#### **Neni 52**

(1) Bashkëpunëtorët profesionalë gjatë punës së vet janë të obliguar në vazhdimësi të përsosjen profesionalisht.

(2) Ministri miraton program vjetor për trajnime për përsosje profesionale të bashkëpunëtorëve profesionalë deri në fund të muajit janar në vitin rrjedhës.

(3) Propozim-programin për trajnime për përsosje profesionale e përpilon dhe propozon Byroja në bashkëpunim me Qendrën dhe Inspektoratin Shtetëror të Arsimit.

#### **Neni 53**

(1) Përsosja profesionale e bashkëpunëtorëve profesionalë realizohet nëpërmjet programeve të akredituara për trajnim, nëpërmjet projekteve të miratuara nga ministria, përsosjes interne profesionale në shkollë, ekipe ndërshkollore për mësim dhe nëpërmjet formave individuale të mësimin.

(2) Përsosja profesionale nga paragrafi (1) i këtij neni realizohet pa u cenuar procesi edukativo-arsimor në shkollë, për çfarë kujdest drejtori i shkollës.

#### **Neni 54**

(1) Bashkëpunëtorët profesionalë janë të obliguar në suazat e përsosjes së vazhdueshme profesionale të kalojnë së paku 60 orë në trajnime gjatë tri viteve shkollore.

(2) Në suazat e trajnimeve nga paragrafi (1) i këtij neni së paku 40 orë janë nga pjesëmarrja në programe të akredituara për trajnim.

(3) Mjetet për trajnimet nga paragrafi (2) sigurohet në buxhetin e Byrosë, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe nëpërmjet projekteve arsimore të miratuara prej Ministrisë.

(4) Akreditimi i programeve për trajnim nga paragrafi (2) i këtij neni bëhet në pajtim me Ligjin për Byronë për Zhvillim të Arsimit.

(5) Çdo bashkëpunëtor profesional në afat prej tri vitesh kalon 20 orë trajnim për programe prioritare të përcaktuara prej ministrit për çfarë mjetet sigurohen në buxhetin e Byrosë.

### **Neni 55**

(1) Për përsosjen e vet profesionale bashkëpunëtori profesional bën plan personal për zhvillim profesional për çdo vit shkollor në bazë të vetevaluimit në lidhje me kompetencat profesionale, rezultatet nga evaluimi integral, inspektimi i drejtorit dhe raporte nga vizitat e këshilltarëve të Byrosë dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

(2) Planin nga paragrafi (1) të këtij neni e miraton drejtori i shkollës me propozim të ekipit për zhvillim profesional në shkollë, nga neni 28 paragrafi (3) i këtij ligji.

### **Neni 56**

(1) Bashkëpunëtori profesional, i cili për shkaqe objektive nuk mund të realizojë pjesë të aktiviteteve të planifikuara në planin personal për zhvillim profesional nga neni 55 paragrafi (1) i këtij ligji, ka të drejtë, në konsultim me drejtorin e shkollës të bëjë ndryshim në planin personal për zhvillim profesional.

(2) Bashkëpunëtorit profesional që nuk e ka realizuar planin personal për zhvillim profesional, e për këtë nuk ka shkaqe objektive, drejtori vitin e ardhshëm shkollor i përcakton zhvillim të përkrahur profesional.

(3) Zhvillim i përkrahur profesional nga paragrafi (1) i këtij neni, nënkupton caktim të bashkëpunëtorit profesional në titull më të lartë ose bashkëpunëtorit profesional tjetër që i ndihmon bashkëpunëtorit profesional në përpunimin dhe realizimin e planit të tij personal për zhvillim profesional.

### **Neni 57**

Për zhvillimin profesional të secilit bashkëpunëtor profesional mbahet dosje profesionale.

## **IX. ZHVILLIM NË KARRIERË I BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONALË**

### **Neni 58**

Bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme mund të përparojnë në tituj.

### **Neni 59**

(1) Kategoria bashkëpunëtor profesional merret me provim të dhënë për praktikant.

(2) Bashkëpunëtori profesional mund të përparojë në tituj bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar.

(3) Standardet profesionale për titujt bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar dhe mënyrën e marrjes i përcakton ministri me propozim të Byrosë dhe Qendrës.

(4) Numrin e bashkëpunëtorëve profesionalë të cilët mund të marrin tituj bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar për çdo vit fiskal e përcakton ministri, me pëlqim paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **Neni 60**

(1) Bashkëpunëtori profesional mund të përparojë në titull bashkëpunëtor profesional-mentor nëse:

- ka së paku shtatë vjet përvojë pune si bashkëpunëtor profesional,
- është i punësuar në kohë pune të pacaktuar dhe
- i plotëson standardet profesionale për bashkëpunëtor profesional-mentor,

(2) Kërkesa për avancim në titull bashkëpunëtor profesional -mentor parashtrohet në Ministri pas thirrjes së shpallur publike, nëpërmjet aplikacionit elektronik në faqen e internetit të Ministrisë me këtë dokumentacion:

- diplomë ose certifikatë për arsim përkatës të mbaruar ose kopje të verifikuar në noter,

- dëshmi për plotësim të standardeve profesionale për bashkëpunëtor profesional -mentor nga dëshmitë e përfshira në dosjen profesionale të bashkëpunëtorit profesional,

- vlerësim nga Byroja dhe mendim nga shkolla për plotësim të standardeve për bashkëpunëtor profesional-mentor dhe

- raport nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për stazh pune të realizuar të bashkëpunëtorit profesional,

(3) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(4) Komisioni nga neni 62 paragrafi (1) i këtij ligji është i obliguar të përgatitë rang-listë nga neni 62 paragrafi (3) i këtij ligji, në afat prej 90 ditësh nga dita e kompletimit të dokumentacionit nga paragrafi (2) i këtij neni.

### **Neni 61**

(1) Bashkëpunëtori profesional-mentor mund të përparojë në titull bashkëpunëtor profesional-këshilltar nëse:

- ka së paku nëntë vite përvojë pune, nga të cilat tri vite në titullin bashkëpunëtor profesional –mentor dhe

- i plotëson standardet profesionale për bashkëpunëtor profesional-këshilltar,

(2) Kërkesa për avancim në titull bashkëpunëtor profesional-këshilltar parashtrohet në Ministri pas thirrjes së shpallur publike, nëpërmjet aplikacionit elektronik në faqen e internetit të Ministrisë, me këtë dokumentacion:

- dëshmi për titull të marrë bashkëpunëtor profesional – mentor,

- dëshmi për plotësim të standardeve profesionale për bashkëpunëtor profesional- këshilltar nga dëshmitë e përfshira në dosjen profesionale të bashkëpunëtorit profesional,

- vlerësim nga Byroja dhe mendim nga shkolla për plotësim të standardeve për bashkëpunëtor profesional- këshilltar dhe

- raport nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut për stazh pune të realizuar të bashkëpunëtorit profesional,

(3) Formën edhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni i përcakton ministri, me propozim të Byrosë.

(4) Komisioni nga neni 62 paragrafi (1) i këtij ligji, është i obliguar të përgatitë rang-listë nga neni 62 paragrafi (3) i këtij ligji, në afat prej 90 ditësh nga dita e kompletimit të dokumentacionit nga paragrafi (2) i këtij neni.

### **Neni 62**

(1) Plotësimin e standardeve profesionale për titujt bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar e kontrollon komision i formuar nga ministri.

(2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni, përbëhet nga: dy përfaqësues prej fakulteteve përkatëse që arsimojnë bashkëpunëtorë profesionalë, një përfaqësues nga sindikata reprezentative për arsim dhe nga një përfaqësues nga Ministria dhe Byroja.

(3) Komisioni i vlerëson aplikacionet e arritura dhe dokumentacionin e bashkëpunëtorëve profesional për marrje të titullit bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar, dhe në pajtim me pikët e fituara të kandidatëve bën rang listë. Bashkëpunëtorët profesionalë të ranguar më lartë sipas

numrit të përcaktuar nga ministri për atë vit, e marrin titullin bashkëpunëtor profesional-mentor, përkatësisht bashkëpunëtor profesional-këshilltar.

(4) Bashkëpunëtori profesional i cili nuk do të jetë i kënaqur me vlerësimin nga komisioni ka të drejtë ankese në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vlerësimit të komisionit.

(5) Mënyrën e formimit të komisionit, vlerësimit të aplikacioneve të pranuar dhe dokumentacionit të bashkëpunëtorëve profesionalë për marrje të titullit bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar, vlerësimin e kandidatëve me pikë, rang listën, si dhe mënyrën e punës së komisionit, i përcakton ministri me propozim të Byrosë.

### **Neni 63**

(1) Bashkëpunëtorit profesional, pa procedurë të zbatuar për rishqyrtim të titullit të marrë, i hiqet titulli i marrë nëse:

- me aktgjykim të plotfuqishëm i është shqiptuar masë ndalimi për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe

- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej më shumë se gjashtë muajsh.

(2) Procedurë për rishqyrtim të titullit të marrë inicion shkolla nëse:

- bashkëpunëtori profesional ka ndërprerje të vazhdueshme të marrëdhënies së punës ose pezullim të marrëdhënies së punës në institucion edukativo-arsimor më tepër se tri vite,

- nuk e realizon planin për zhvillim personal profesional dhe si rezultat i kësaj bashkëpunëtorit profesional i është caktuar zhvillim i përkrahur profesional në periudhë të caktuar kohore dhe

- nuk i realizon detyrat e punës së bashkëpunëtorit profesional-mentor përkatësisht bashkëpunëtorit profesional-këshilltar.

(3) Procedurë për rishqyrtim të titullit të marrë nuk inicionet nëse bashkëpunëtori profesional ka ndërprerje të vazhdueshme të marrëdhënies së punës në institucion edukativo-arsimor më shumë se tri vite për shkak të udhëzimit për përsosje profesionale nga ana e punëdhënësit.

(4) Iniciativë për heqje të titujve të marrë parashtron drejtori i shkollës në të cilën punon bashkëpunëtori profesional, Byroja, ose Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe dërgohet në Ministri.

(5) Ministri formon Komision për heqje dhe rishqyrtim të titujve të bashkëpunëtorëve profesionalë, që përbëhet prej tre anëtarëve, nga të cilët njëri është nga radha e punonjësve në Byro, përkatësisht Qendër, një nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe një nga sindikata reprezentative e arsimit.

(6) Komisioni jep propozim për heqje të titullit ose propozim për refuzim të iniciativës nga paragrafi (4) i këtij neni, te ministri.

(7) Ministri në bazë të propozimit nga paragrafi (6) i këtij neni miraton aktvendim.

(8) Kundër aktvendimit të ministrit nga paragrafi (7) i këtij neni mund të parashtrohet ankesë në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

### **Neni 64**

Detyrat e punës së bashkëpunëtorëve profesionalë me titull bashkëpunëtor profesional-mentor, përveç obligimeve nga neni 44 i këtij ligji, përfshijnë edhe:

- mentorim të bashkëpunëtorit profesional-praktikant;

- mentorim të studentëve prej fakulteteve përkatëse;

- ndjekje dhe orientim të zhvillimit profesional të punonjësve në shkollë,
- inkorporim të qasjeve inovuese në punën edukativo-arsimore të shkollës dhe udhëheq me zbatimin;
- inicim dhe zhvillim të bashkëpunimit partnerial me familjen dhe komunitetin për çështje relevante për komunitetin nga aspekti i arsimit;
- përpilim të politikave zhvillimore të shkollës dhe
- detyra tjera në pajtim me kompetencat e marra për bashkëpunëtor profesional-mentor.

#### **Neni 65**

Detyrat e punës së bashkëpunëtorëve profesionalë me titull bashkëpunëtor profesional-këshilltar, përveç obligimeve nga neni 44 i këtij ligji, përfshijnë edhe:

- mentorim të studentëve prej fakulteteve përkatëse;
- mentorim të kolegëve që kanë zhvillim të përkrahur profesional;
- kryerje të hulumtimeve komplekse relevante për arsimin në kontekst më të gjerë;
- menaxhim të procesit të planifikimit zhvillimor në shkollë dhe propozon politika shkollore për cilësi;
- identifikim të fushave dhe mënyrave të reja për bashkëpunim të shkollës me familjen dhe komunitetin dhe ka rol udhëheqës në implementim dhe
- detyra tjera në pajtim me kompetencat e marra për bashkëpunëtor profesional-këshilltar.

### **X. TRANSFORMIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS TË MËSIMDHËNËSIT DHE BASHKËPUNËTORIT PROFESIONAL**

#### **Neni 66**

(1) Në veprimtarinë e arsimit fillor dhe të mesëm transformimi i marrëdhënies së punë nga koha e caktuar në kohë të pacaktuar lejohet vetëm nëse:

- mësimdhënësi, përkatësisht bashkëpunëtori profesional ka stazh pune më shumë se dy vite në institucion edukativ arsimor të verifikuar nga Ministria, me ndërprerje ose pa ndërprerje,
- mësimdhënësi, përkatësisht bashkëpunëtori profesional është në vendin e përhershëm të punës të liruar në bazë të pensionimit, largimit, vdekjes ose baza tjera dhe janë siguruar mjete financiare për të cilin kërkohet transformimi,
- mësimdhënësi, përkatësisht bashkëpunëtori profesional i plotëson kushtet e parapara me normativin për mësimdhënësi/bashkëpunëtor profesional,
- mësimdhënësi, përkatësisht bashkëpunëtori profesional e ka dhënë provimin profesional dhe
- punëdhënësi konstaton se ka nevojë permanente për mësimdhënësi, përkatësisht bashkëpunëtorin profesional dhe kjo nuk do të shkaktoj tepriçë teknologjike dhe
- është marrë pajtim për transformim të vendit të punës nga Ministria.

(2) Kërkesën për transformim të marrëdhënies së punës shkolla e parashtron te Komisioni për Transformim të Marrëdhënies së Punës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Transformim), të cilin e formon kryetari i komunës, përkatësisht kryetar i Qytetit të Shkupit, përkatësisht ministri për shkollat fillore dhe të mesme shtetërore dhe përbëhet nga tre anëtarë, si vijon: nga një anëtar nga komuna/Qyteti i Shkupit, përkatësisht Ministria, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe përfaqësues të sindikatës reprezentative të arsimit. Kryetar i Komisionit për Transformim është përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

(3) Komisioni për transformim formohet për periudhë prej tre vitesh.

(4) Me kërkesën për transformim të marrëdhënies së punës, te Komisioni për Transformim shkolla parashtron:

- raport për stazh pune të realizuar të mësimdhënësit nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- deklaratë nga drejtori i shkollës që vendi i punës për cilin kërkohet transformimi është i liruar në bazë të pensionimit, largimit, vdekjes ose baza tjera dhe janë siguruar mjete financiare,
- deklaratë nga drejtori i shkollës se ka nevojë permanente për mësimdhënësin, përkatësisht bashkëpunëtorin profesional dhe se nuk do të shkaktojë tepricë teknologjike,
- kopje të diplomës/certifikatës për arsim përkatës të mbaruar në pajtim me normativin,
- kopje të certifikatës për provim të dhënë profesional dhe
- analizë të vendeve të punës në nivel të shkollës.

(5) Komisioni për Transformim bën kontroll të dëshmimeve nga paragrafi (4) i këtij neni dhe përpilon raport me propozim për transformim vetëm për mësimdhënës përkatësisht bashkëpunëtor profesional të cilët i plotësojnë kushtet për transformim të marrëdhënies së punës. Raporti me propozimin duhet të përmbajë edhe analizë të vendeve të punës në nivel të shkollës dhe të komunës/Qyteti të Shkupit dhe i njëjti detyrimisht duhet të jetë i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Transformim.

(6) Komisioni për Transformim për shkollat fillore dhe të mesme komunale/të Qytetit të Shkupit, raportin me propozimin nga paragrafi (5) të këtij neni, e parashtron në Ministri.

(7) Mësimdhënësve, përkatësisht bashkëpunëtorëve profesional të cilët nuk i plotësojnë kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni, Komisioni për Transformim ua kthen dokumentet e shkollës me arsyetim në afat prej shtatë ditësh nga dita e shqyrtimit të të njëjtave.

(8) Drejtori i shkollës në bazë të njoftimit nga paragrafi (7) i këtij neni, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit, merr vendim për refuzim të transformimit të marrëdhënies së punës.

(9) Mësimdhënësi, përkatësisht bashkëpunëtori profesional i cili nuk është i kënaqur nga vendimi nga paragrafi (8) i këtij neni, ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në Komisionin Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë për Marrëdhënie të Punës në Shkallë të Dytë.

(10) Ministria në bazë të raportit me propozimin nga paragrafi (5) i këtij neni për mësimdhënësin, përkatësisht bashkëpunëtorin profesional që i plotëson kushtet për transformim të marrëdhënies së punës jep pëlqim për transformim të marrëdhënies së punës.

(11) Drejtori i shkollës në bazë të njoftimit nga paragrafi (10) i këtij neni, në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të pëlqimit, merr vendim për transformim të marrëdhënies së punës.

## **XI. MBIKËQYRJA**

### **Neni 67**

(1) Mbikëqyrje në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryen Ministria.

(2) Mbikëqyrje inspektuese në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji kryejnë Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe inspektorët e autorizuar komunal në pajtim me ligjin.

## **XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 68**

Dispozitat nga neni 3 paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij ligji, nuk vlejné për mësimdhënësit të cilët janë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në shkollat fillore dhe të mesme në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozita nga neni 39 paragrafi (1) alineja 1 e këtij ligji nuk vlen për bashkëpunëtorët profesionalë të cilët janë në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në shkolla fillore dhe të mesme në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 69**

(1) Deri në vitin 2022 detyrat e punës së mësimdhënësit-mentor mund t'i kryejë mësimdhënësi i cili ka stazh pune së paku shtatë vite si mësimdhënës.

(2) Deri në vitin 2022 detyrat e punës së bashkëpunëtorit profesional-mentor mund t'i kryejë bashkëpunëtor profesional që ka stazh pune së paku shtatë vite si bashkëpunëtor profesional.

#### **Neni 70**

Procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në pajtim me Ligjin për arsimin fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18), përkatësisht Ligjin për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18).

#### **Neni 71**

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 72**

Deri në miratimin e akteve nënligjore të parapara me këtë ligj, zbatohen aktet nënligjore që kanë qenë në zbatim deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 73**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen Ligji për mësimdhënës në shkolla fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 10/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 220/18) dhe Ligji për Akademi për Mësimdhënës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 10/15, 192/15, 30/16, 127/16, dhe 220/18).

#### **Neni 74**

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen neni 59, neni 59-v paragrafi (1), paragrafi (2) alinetë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10, në nenin 60 dispozita që kanë të bëjnë me mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë, neni 61, neni 62, neni 63, neni 65, neni 66, neni 67, neni 68, neni 68-a, neni 69, neni 69-a, neni 70, neni 71, neni 72 dhe neni 72-a të Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18).



### **Neni 75**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazeta Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.